



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Në pajtim me nenin 132 dhe 133 të Kushtetutës të Republikës të Kosove, Ligjin nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, Rregulloren nr.01/2016 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, Rregulloren e punës në Institucionin e Avokatit të Popullit nr.02/2016 dhe Rregulloren nr.02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionit të Avokatit të Popullit, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall:

K O N K U R S

I. Titulli i vendit të punës: Këshilltar i lartë juridik për bashkëpunim, raportim, dhe promovimin e të drejtave të njeriut, një (1) pozitë

Numri i referencës: 5/2017

Grada/Koeficienti: Niveli Profesional – G3/16.77

Mbikqyrësi: Drejtori departamentit për bashkëpunim, raportim, dhe promovimin e të drejtave të njeriut

Kohëzgjatja e emërimit: Pa afat, duke përfshirë periudhën e punës provuese 1(një) vjeçare.

Vendi: Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të vendit të punës:

1. Bashkëpunon me institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në zbatimin e mandatit dhe përgjegjësi të departamentit, në pajtim me legjislacionin në fuqi, përcaktimet dhe autorizimet e Avokatit të Popullit.
2. Përcjell dhe analizon Dokumentet Strategjike të Qeverisë dhe institucioneve tjera, të cilat janë në procedurë hartimi dhe të atyre në zbatim e sipër lidhur me mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës dhe varësisht nga gjetjet edhe bën rekomandimet përkatëse në kohë dhe afate optimale
3. Informon publikun për punën e IAP-së nëpërmjet publikimit të raporteve vjetore dhe të veçanta, opinioneve dhe rekomandimeve, si dhe përmes organizimit të seminareve, tryezave të përbashkëta, konferencave, takimeve dhe ngjarjeve të ndryshme me autoritetet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe me organizatat që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.
4. Ndihmon në përmbledhjen e Raporteve vjetore të punës së IAP-së, dhe raporteve periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit mbi bazën e raporteve vjetore dhe periodike të punës së njësive organizative.
5. Bënë përmbledhjen e informacioneve nga interneti për veprimtarinë e institucioneve homologe dhe organizmave kryesor ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe për këto informon drejtorin e departamentit dhe drejtuesit e njësive organizative përkatëse.
6. Bënë hulumtime mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës dhe, para se të publikohen, të njëjtat i'a përcjell drejtorit të departamentit për miratim paraprak.
7. Përgatit informacione për opinionin publik për rastet e diskriminimit dhe propozon masa për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimin.
8. Bën të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, informimit, edukimit, trajnimeve, dhe kontakteve të drejtpërdrejta me aktoret e zbatimit të ligjit dhe mediat.
9. Përgatit rekomandime për autoritetet kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me promovimin, avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe mosdiskriminimit, dhe të njëjtat ia përcjell Avokatit të Popullit për aprovim dhe publikim.
10. Bashkëpunon me donatorët dhe organizatat joqeveritare, që merren me çështje të barazisë dhe mosdiskriminimit, për vetëdijesimin e institucioneve dhe publikut të gjerë lidhur me mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

11. Merr pjesë në seminare, trajnime dhe konferenca, në suaza të trajtimit të qështjeve nga fushveprimtaria e departamentit dhe temave që ndërlihen me diskriminimin, të drejtat e njeriut dhe përgjegjësit.
12. Përpilon raporte të rregullta pune nga fusha e përgjegjësi dhe detyrave të caktuara si dhe kontribuon në përgatitjen e Planit Vjetor te punës se Departamentit.
13. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

- Diplomë universitare në shkencat juridike.
- Minimum 3 (tri) vjet përvojë pune profesionale.
- Njohje të shkëlqyeshme në të folur dhe të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe, ndërsa preferohet njohja e mirë e gjuhës angleze në të folur dhe në të shkruar.
- Trajnime përkatëse në fushën e të Drejtave të Njeriut.
- Vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale, jo më i vjetër se 6 muaj.

Procedura e konkurimit

Procedura e konkurimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i përmbushin kriteret e konkursit.

Formularët për punësim mund të merren në zyrën e IAP, apo në ueb faqen: www.ombudspersonkosovo.org.

Formularët për punësim dorëzohen brenda afatit të përcaktuar me Konkurs personalisht në zyrën qendrore të Institucionit të Avokatit të Popullit në Prishtinë, Rr. „Migjeni“, nr. 21, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, përmes postës elektronike në adresën zyraepersonelit@ombudspersonkosovo.org, si dhe me anë të shërbimit postar.

Formularit për punësim i bashkëngjiten kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe dëshmitë për kualifikim, përvojë të punës, trajnimet e ndjekura si dhe vërtetimin se nuk është nën hetime apo i dënuar për vepër penale.

Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët

Institucioni i Avokatit të Popullit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjitha shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga pjestarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Data e fundit për aplikim është 21 shkurt 2017, ora 16:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët që kanë aplikuar, por nuk janë përzgjedhur, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre pas përfundimit të procedurës së rekrutimit dhe të ankimimit. Dokumentet që nuk tërhiqen administrohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në nurmin e telefonit 038 223 782.